



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 486 Prot

Vlorë, më 03 . 04 .2024

VENDIM

Nr. 8 datë 26.03 .2024

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT STRATEGJIK "VLORA 2030 -VALORIZIMI I THIRRJEVE TERRITORIALE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË QARKUT TË VLORËS”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”; Ligjit 37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KEE për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, i ndryshuar; Kontratës së Grantit të Projektit “Rezilienza Marginale” AID 012314/02/5.

Në përputhje me nevojat dhe synimet e përgjithshme për zhvillimin dhe përmirësimin e territorit të Qarkut të Vlorës, duke përfshirë edhe aspektet e zhvillimit ekonomik dhe turizmit;

VENDOSI:

1. Të miratohet Dokumentit Strategjik "Vlora 2030 - Valorizimi i thirrjeve territoriale për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës".
2. Këshilli i Qarkut të Vlorës dhe sektorët e përfshira do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Planit Strategjik, duke siguruar koordinimin dhe monitorimin e rregullt të progresit të arritur.
3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas parashikimit të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI

Ervis Mocka



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. _____ Prot, datë _____ .2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
RELACION**

Të nderuar Këshilltarë !

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”; Ligjit 37/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KEE për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)II”, i ndryshuar; Kontratës së Grantit të Projektit “Rezilienza Marginale” AID 012314/02/5.

Në kuadër të projektit “Rezilienza Marginale” në të cilën Këshilli I Qarkut të Vlorës është partner, janë organizuar një sërë takimesh në komunitet dhe gjithë përfshirëse, nga ekspertë të Rajonit të Pulias dhe ekspertë të Këshillit të Qarkut Vlorë. Në të gjitha këto takime është diskutuar për nevojat e territorit për të pasur një plan strategjik për zhvillimin e turizmit jo vetëm detar por edhe sektoreve të tjerë të ekonomisë .

Në mbledhjen e datës 19 Mars 2023 u prezantua nga ekspertë me eksperiencë disa vjecare në ndërtimin e strategjive për zhvillim dhe partnerët Italian të projektit “Rezilienza Marginale” “Dokumentit Strategjik “Vlora 2030 - Valorizimi i thirrjeve territoriale për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës”. Ky plan është i ndërtuar në përputhje me nevojat dhe synimet e përgjithshme për zhvillimin dhe përmirësimin e territorit të Qarkut të Vlorës. Plan i është përbërë nga 180 faqe në të cilat shpjegohet potenciali i zhvillimit ekonomik të qarkut në këtë plan veprimi është fokusuar në dy drejtime strategjike TURIZËM dhe BUJQËSI.

Disa pika në të cilat mbështet plani janë:

TURIZËM

Në plan evidentohet dhe analizohet turizmi bregdetar si me klasiku por i cili për shkak të masivitetit ka rezultuar me efekte negative në mjedis. Ndaj dhe diversifikimi i ofertës turistike ka qënë një domosdoshmëri për të orientuar modelin e zhvillimit drejt qëndrueshmërisë. Pikat e dobta përmëdim jo vetëm ofertën turistike të limituar, por edhe sezonin turistik të reduktuar (edhe pse në rritje krahasuar me vitet më parë), akomodimi i pamjaftueshëm, mungesa e standarteve të certifikimit të operatorëve turistike, mbipopullimi dhe menaxhimi i fluksit të turistëve.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria” Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

TURIZMI I PLAZHIT

Per administratën publike me fokus në menaxhimin e mjedisit, urbanistikes, plazhet, komunikimin dhe sensibilizimin per zhvillimin e qendrueshem dhe sigurine. Ndërkohe për sektorin privat propozohet krijimi I një projekti pilot, bazuar në aktivizimin e një ose më shumë konsorciumeve për vlerësimin dhe promovimin e Rivierës së Vlorës. Duke pasur parasysh karakteristikat e territorit bregdetar, sugjeron krijimin i një konsorciumi për bregdetin jugor. Në disa rajone italiane, ky model është aktualisht i përhapur dhe përfitimet që ai sjell për sipërmarrësit privatë dhe imazhi i territorit konsiderohen tashmë të domosdoshëm.

TURIZMI DETAR

Si një nga komponentet kryesor I ekonomisë Blu, ky sektor është në fazat e para të zhvillimit në Shqipëri, I mbështetur nga ndryshime ligjore dhe lehtësira fiskale për kategori të vecanta si në rastin e jahteve. Analizohet në plan Vlora Marina, Marina Orikum, Lungomare 3. Jepen line guida mbi përmirësimin e infrastruktures, standarteve dhe normave për sigurinë në lundrim, rritjen e kapaciteteve të operatoreve që operojnë në këtë fushë dhe personelit, përmirësimi I teknologjisë duke reduktuar ndotjen.

TURIZMI KULTUROR

Trajtohen në plan tre sitet me interest te lartë turistik parku arkeologjik I Finiqit, Orikumit dhe Amantias si dhe qendrat historike Vlore, Himare, Qeparo, Vuno dhe Dhërmi. Në plan analizohen edhe zonat e mbrojtura natyrore me potencial të jashtëzakonshëm turistik, specifikisht Parku Kombëtar Llogora, Parku Kombëtar Karaburun-Sazan, Parku Kombëtar, Lumi Vjosa dhe, Parku Kombëtar Butrint. Edhe per kete sektor jane dhene disa udhezime si per institucionet dhe subjektet private qe konsistojne kryesisht ne promovim me te mire te destinacioneve dhe diversifikimin e aktiviteteve ne menyre qe te terheqi sa me shume vizitore, zbatimi I modeleve te

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE**

zhvillimit te qendrueshem, perfshirja e komuniteteve lokale ne vendimmarrje, permiresimi I infrastruktures per te ofruar eksperienca sa me autentike si ngritja e qendrave te vizitoreve si dhe pikave te shitjes prane museve dhe siteve kulturore etj.

FESTIVALE DHE EVENTE, TURIZMI SPORTIV DHE I AVENTURES DHE TURIZMI RURAL DHE AGROTURIZMI

Evente sociale (me natyre fetare), panaire, merkata, evente sportive dhe kulturore. Propozim I eventeve të mëdha si mundësi zhvillimi për Qarkun Vlorë duke ndihmuar në shtrirjen e sezonit turistik, shpenzim më I lartë I turisteve në zona rurale, mundësi punësimi për banoret dhe promovim I destinacioneve. Plani jep modele mbi planifikimin e eventeve ne menyre te tille qe te siguroj nje benefit sa me te larte per komunitetin, duke nderthurur vlerat natyrore, kulturore dhe peizazhistike.

Sportet, peizazhet e larmishme, zonat natyrore, agroushqimet etj jane katalizatorë të turizmit dhe mundësi për modele të zhvillimit të qëndrueshëm. Planifikimi dhe promovimi i paketave turistike ku të gjithë këto elemente ndërthuren është analizuar në plan së bashku me nevojën për të hartuar një plan strategjik për marketimin e turizmit të integruar si dhe menaxhimin e destinacioneve.

Në plan analizohet bashkëpunimi midis operatoreve Italianë dhe Qeverisë shqiptare me qëllim që të sjellin modelin italian të fshatrave dhe konsorciumeve në Rajonin e Vlorës. Prandaj, një qëllim i përbashkët është të rritet dhe të forcohet veprimtaria e agroturizmit, në mënyrë që fermerët jo vetëm të prodhojnë, por të transformojnë autenticitetin e tyre të veçantë në artin e mikpritjes, ashtu siç ndodh në fshatrat e vogla italiane.

Për turizmin rural në plan janë dhënë një sërë udhëzimesh strategjike për zhvillimin e e ketij sektori duke stimuluar ndërtimin e Modelit të Turizmit Rural të Vlorës.

Tetë faktorë të cilët kontribuojnë në turizmin rural në Rajonin e Vlorës si dhe identifikimi të synuara për promovim analizohen në plan.

RRUGËT E VERËS DHE TË VAJIT

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

Plani përshkruan strukturën dhe dinamikën e turizmit ushqimor dhe të verës, nga ku zhvillohet dhe ideja e "Rrugëve të Verës dhe Ullirit", të zhvilluara dhe një komponent shumë i rëndësishëm i planifikimit strategjik turistik në Itali. Plani i veprimit propozon përdorimin e strategjive të marketingut për të krijuar një "Rruga e Verës së Vlorës" në Rajonin e Vlorës.

BUJQËSIA

PRODHIMI I RRUSHIT DHE VERES

Varietetet vendase, të vlerësuara gjithnjë e më shumë, përfaqësojnë një pikë të fortë për prodhuesit e verës, plani propozon indikacione strategjike për zhvillimin e këtij sektorit, duke identifikuar dhe përshkruar "shtatë faktorë suksesi për konsolidimin e sektorit të verërave në Qarkun Vlorë", dhe duke sugjeruar se cilat janë dhjetë panairët ndërkombëtare për t'u vizituar dhe studiuar me vëmendje të veçantë.

PRODHIMI I ULLIRIT DHE VAJIT TË ULLIRIT

Plani propozon një sërë udhëzimesh strategjike për zhvillimin e këtij sektori dhe "Njëmbëdhjetë faktorëve kritikë të suksesit për sektorin e vajit të ullirit" në Qarkun e Vlorës".

BUJQESIA ORGANIKE

Plani fokusohet në analizen e këtij sektori, përfshirë prodhues, përpunues dhe eksportues. Plani vazhdon duke vlerësuar tregun e bujqësisë organike dhe prezantuar kuadrin legjislativ dhe rregullator. Në plan prezantohen:

- "Tre faktorëve kritikë për suksesin e bioagrikulturës në qarkun e Vlorës";
- Paragrafin "Bimet aromatike dhe mjekësore: një vend i çmuar për t'u kultivuar në Qarkun e Vlorës";
- Prezantimi i destinacioneve të privileguara të eksportit të produkteve organike të prodhuara në Qarkun Vlorë.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Përsa më sipër propozoj miratimin nga këshilltarët e Këshillit të Qarkut Vlorë, të këtij Plani Strategjik Territorial.

Specialist per Arsimin, Kulturën, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Ilda Lamaj

KRYETARI

Ervis Moçka



Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600